



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

V E N D I M

Nr. 19, datë 28.01.2025

PËR

MIRATIMIN E NDYSHIMIT TË PROJEKTIT GJATË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“MARINA DHE JAHTET E DURRËSIT, FAZA 1, PUNIME DETARE” ME

VENDNDODHJE NË BASHKINË DURRËS

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, me propozim të zhvilluesit “Durrës Marina” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të projektit gjatë ndërtimit për objektin: “Marina dhe Jahtet e Durrësit, Faza 1, Punime Detare”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Durrës Marina” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur Vendimit Nr. 04, datë 18.10.2023 të Këshillit Kombëtar të Territorit, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga kryetari, ministri i linjës dhe sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALEUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 22/09 2025